



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1819/10 prot

Datë 04.09.2023

V E N D I M

Nr. 862/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2023 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “*Loti 1, ‘Blerje kite dhe reagentë’*” me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal “Memorial” Fier
Fier

Ankimues: Operatori ekonomik “Medfau” SHPK me NIPT J93610823R dhe adresë: Lagja 5, Kavajë, Tiranë

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “Pegasus” SHPK me NIPT J62903750A dhe adresë: Ruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.05.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “Loti 1, ‘Blerje kite dhe reagentë’” me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

II.2. Në datën 04.07.2023, operatori ekonomik “Medfau” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij si më poshtë:

“Medfau” SHPK
“Pegasus” SHPK

57 803 600 lekë, skualifikuar
64 265 500 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Medfau” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

Vlerësimi për OE Medfau:

1. Nuk plotësohet Kriteri 1.c - Nuk është paraqitur Formulari Permbledhës i Vetedeklarimit sipas Shtojcës 8 si në formë ashtu edhe në permbajtje. Qëndrim i mbajtur edhe nga KPP me Vendimin nr.183 dt.09.03.2023.

2. Nga kërkesat për pajisjet në përdorim, nuk plotësohet pika c “autorizimi i prodhuesit” - Është ofruar pajisja Koagulometer CA 600 e prodhuesit Siemens, ndërsa Autorizimi i Prodhuesit është për pajisjen Koagulometer CA 560.

3. Nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara për pajisjet në përdorim si vijon:

3.1. Pajisja Analizator Imunologjik: Modeli Advia Centaur XPT e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk plotëson specifikimet: (i) Si pajisje primare, nuk plotëson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin CMA” - ofruar me metodologjinë e kemiluminishencës kimike; (ii) Si pajisje back-up, nuk plotëson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA”.

3.2. Pajisja Analizator Hematologjik: Modeli Advia 560 e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk plotëson specifikimin “Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl” – pajisja e ofruar ka vëllim maksimal të mostrës 110 µl.

3.3. Pajisja Analizator për Gazet në Gjak: Modeli Rapid Point 500, nuk plotëson specifikimin “Mostra e përdorur: 2-3 pika gjak i plote ose plasmë”.

3.4. Pajisja Analizator Koagulimi, është ofruar modeli CA 600 por nuk ka autorizim prodhuesi për këtë model por për modelin CA 560. Sidoqoftë, edhe modeli CA 600 i ofruar, nuk plotëson specifikimet e kërkuara, konkretisht: (i) “Aparati back up gjysëmatomik” – ofruar të dy aparatet automatik; (ii) “Metodologjia: Sistemi i detektimit I bazuar në viskozitet” – ofruar Photo-optical, continuous, sequential (Clotting/4, chromogenic, * and immunologic*); (iii) “Kapaciteti rreth 100 mostra” – max i ofruar nga pajisja është 60; (iv) “Te ofroje mundësinë e analizimit prioritar të mostrave STAT” – ofron vetëm 1 (STAT 1 priority position); (v) “Te jete i paisur me të paktën 4 kohëmatës të inkuorporuar në aparat me alarm zanor” – nuk e ofron.

3.5. Pajisja Analizator Biokimik: Modeli Dimension EXL 200, e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, si pajisje primare nuk plotëson specifikimin “Kapaciteti jo më pak se 800 teste/ore”.

3.6. Pajisja Analizator Urine: Model i ofruar Clinitec Status, nuk plotëson specifikimin “Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore”.

II.3. Në datën 18.07.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 26.07.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1819/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3307 e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “Loti 1, “Blerje kite dhe reagentë” me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “Medfau” SHPK. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Referuar pikes 1. Formulari permbledhes i vetedeklarimit sipas shtojces 8 eshte dorezuar nga operatori ekonomik duke ju permbajtur modelit te paraqitur ne DST. Bashkengjitur draft modeli ne DST dhe formulari i dorezuar ne APP.

Referuar pikes 2. Koagulometri i ofruar CA-660 i serise CA-600 eshte ekuivalent me pajisjen CA-560 e serise 500. CA-660 ofron permiresime te cilat nuk ndikojne ne tekniken e perdorur apo numrin e ASSAYS qe sistemi automatik ofron por vetem ne funksionalitetet qe ai ka, ndryshime keto te cilat lehtesojne perdoruesin (per shembull prania e ekranit me ngjyra). Dokumentacioni e dorezuar per CA660 perkon me nje pajisje me te avancuar krahuar me pajisjen qe eshte paraqitur dokumentacioni i autorizimit nga prodhuesi. Te dyja keto pajisje jane pjese e portofolit te koagulimit te serise CA-500, CA-600 dhe si rrjedhoje autorizimi per CA-660 nga prodhuesi Siemens mund te ofrohet.

Referuar pikes 3.1. Sipas kerkeses se kryer ndaj AK (bashkengjitur nje kopje) eshte kerkuar qe AK te vendos fjalen Ekuivalent ne percaktimin e pajisjeve/teknikes se matjes se nevojshme ne perdorim. Kjo e bazuar ne ligjin nr 162 date 23.12.2020 Neni 36 pika 4. Gjithashtu eshte e nevojshme te ritheksohet qe 2 teknologjite e kerkuara ne tender perkatesisht CMIA dhe ELFA qartesisht i referohen 2 kompanive specifike si ABBOT dhe BIOMERIEUX. Nderkohe bazuar ne autoritetet nderkombetare ne fushen e diagnostikes laboratorike CLIA (Immunoassay bazuar ne Kemiluminishence) dhe CMIA (Immunoassay bazuar ne Kemiluminishencen e mikrogrimcave) jane teknika te cilat bazohen ne menyre te njejte mbi parimin e Kemiluminishences.

Referuar pikes 3.2. Ne nje ambient spitalor ku per moshat pediatrike kerkohet volum minimal i kampionit, si ne rastin kur nevojitet vleresimi i hemogrames, tubat me aditiv K2/3ETDA per pediatriket te cilat ofrohen nga prodhues prestigjioz (per shembull. Becton, Dickinson) kerkojne volum te gjakut komplet jo me pak se 0.5 ml (500 mikroliter), volum i cili, per specialiste te mirefillte te laboratorit, eshte i nevojshem per te kryer, ne rast nevojje, rimatje te parametrave hematologjike si dhe per te kryer ekzaminime te tjera si psh strisho te gjakut etj. Kerkesa per pajisje e cila aspiron 15 mikroliter gjak, nga ana teknike, eshte ne kundërshtim me standardet nderkombetare si dhe specifike per nje prodhues te caktuar (psh aparati hematologjik MINDRAY BC5000).

Referuar pikes 3.3. Percaktimi i volumit te nevojshem te mostres ne tender, shprehur ekzaktesisht si 2 deri 3 pika gjaku eshte percaktim i pasaktesuar me arsyetimin qe nuk cilesohet volumi i sakte i cili nevojitet per te kryer ekzaminim. Zakonisht nje pike eshte e barazvlefshme me 50 mikrolitra por ne varesi te densitetit te materialit qe aspirohet dhe ose faktoreve te tjere fizik, sikunder pipeta/dropper e perdorur, volumi i nje pike mund te jete 70 mikrolitra. Pajisjes se ofruar e cila eshte per perdorim ne laborator/dhoma emergjence/ reanimacion i nevojitet

volum maksimal i gjakut komplet prej 100 mikrolitrash. Gjithashtu, specifikat e percaktuara ne tender mbi pajisjen portable i referohet nje pajisje e cila eshte per perdorim bed site (nuk eshte e projektuar per perdorim ne laborator) i referohet specifikesht prodhuesit ABBOT me pajisjen I-STAT. Per me shume, pajisjet per perdorim bed site te cilat kryejne ekzaminime ne mostra me "volum" 2 deri 3 pika nuk sigurojne saktesine ne matjen e gazrave ne gjak. Gjithashtu, specifikimi per perdorimin e kampionit plazem ne percaktimin e gazrave ne gjak nuk qendron shkencisht sepse per kete lloj ekzaminimi nevojitet gjak total venoz ose arterial. Pajisja e ofruar Rapid Point 500 nga Siemens eshte pajisje e perdorur gjeresisht ne spitale dhe labore prestigjoze duke ofruar, nga pikepamja teknike, performance te larte ne percaktimin e gazrave ne gjak. Kjo eshte nje pajisje e cila eshte projektuar per perdorim nga profesioniste mjekesore ne ambientet laboratorike/dhoma emergjence/ reanimacion.

Referuar pikes 3.4. Pajisjet e ofruara nga ne si ajo kryesore dhe ajo Back-Up jane pajisje automatike te cilat mundesojne dhe sigurojne perseritshmeri dhe saktesi analitike si edhe konsum 2 here me te vogel te reagentit dhe volumit te kampionit krahasuar me pajisjen manuale. Persa i perket teknikes se matjes pajisja e ofruar disponon teknologji te nje shkalle me te avancuar krahasuar me systemin e detektimit te bazuar ne viskozitet, specifike kjo cilesuar ne proceduren e prokurimit. Gjithashtu edhe pse ne specifikat e tenderit nuk eshte cilesuar lloji i analizave te cilat parashikohen te kryhen ne analizatorin e hemostazes pajisja e ofruar ka kapacitetet teknike per te mbuluar pothuajse te gjithe gamen e analizave qe i perkasin testeve te koagulimit perfshire ketu dhe tekniken Imunologjike qe perdoret ne si standard i arte per percaktimin e D-Dimer qe sipas rekomandimeve te autoriteteve nderkombetare nuk rekomandohet te kryhet me ane te teknikave bazuar ne viskozitet.

Gjithashtu, numri i ekzaminimeve te kryera ne intervalin kohor prej 60 minutash, i cili varet nga kombinimi i ekzaminimeve qe kryhen (PT, APTT, Fib etj) element ky i cili nuk eshte cilesuar ne kerkesat e tenderit permbushet nga pajisja e ofruar, e cila ne specifikat teknike te saj ku cilesohet 60 teste ne ore per testin PT nenkupton 2 matje paralele per secilin kampion. Pra numri total i testeve qe kryhen ne intervalin prej 60 minutash eshte 120 teste.

Ne kerkesat tuaja mbi analizimin e mostrave ne funksionalitetin STAT nuk eshte cilesuar numri i pozicioneve STAT qe duhet te jene ne dispozicion per matje. Nderkohe, pajisja e ofruar nga ne ka ne dispozicion specifikat per te kryer ekzaminime STAT ne 1 pozicion. Ky specifikim eshte i permbushur nga ana jone. Ne lidhje me pranine e kohematesve duhet theksuar qe keto specifika jane per pajisje gjysem-automatike dhe duke qene qe nga ana jone eshte ofruar pajisje automatike ky specifikim eshte i permbushur.

Referuar pikes 3.5 Sipas katalogut te paraqitur pajisja per kryerjen e ekzaminimeve biokimike Siemens Dimension EXL200 kryen 440 teste fotometrike ne ore plus 187 teste/ore te IMT (Integrated Multisensor technology) plus 167 teste imunometrike ne ore shumatorja e te cilave eshte 794 teste/ore. Megjithate duhet theksuar qe specifikat teknike te cdo prodhuesi mbi numrin maksimale te testeve qe kryhen/ore jane ne varesi te kombinimit te testeve te ndryshme qe analizohen ne te njejten kohe. Pershkrimi i mesiper sidomos ka vlere per sistemet e matjes te cilat bazohen ne funksionalitetin Random Access, funksionalitet ky i pranishem ne cdo pajisje bashkohore laboratorike.

Referuar pikes 3.6. Kerkesa juaj per 600 teste ne ore per sistem gjysem automatik (ne varesi te operatorit) eshte i mbispecifikuar."

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1819/2 date 27.07.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Medfau” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Në datën 03.08.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1819/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 969/4 prot., datë 01.08.2023 me objekt: “*Dërgohet vendimi i KSHA-së*”, bashkëngjitur Vendimi nr. 2, datë 01.08.2023, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës. Referuar këtij vendimi rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “Medfau” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1819/6 prot., datë 24.08.2023 me objekt: “*Njoftim për seancë dëgjimore*”, Komisioni i Prokurimit Publik njoftoi autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues për zhvillimin e një seance dëgjimore, ditën e martë , datë 29.08.2023, në ambientet e këtij institucioni, lidhur me mospërmbushjen e kërkesave për specifikimet teknike për pajisjet në përdorim, nga ana e ankimuesit.

II.8. Në datën 29.08.2023, ora 11.00, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “Medfau” SHPK, të autoritetit kontraktor dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt një seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, dhanë argumentet e tyre lidhur me arsyet e skualifikimit për specifikimet teknike të ankimuesit. Në seancën dëgjimore, Komisioni ngriti pyetjet për autoritetin kontraktor, si dhe u la afat dy ditë kohë përfaqësuesve të të dyja palëve për të paraqitur me shkrim argumentet e tyre lidhur me pyetjet e ngritura në këtë seancë.

II.9. Në datën 29.08.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1819/7 prot., shkresa e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK me argumente shtesë, bashkëlidhur dokumentacioni që mbështet këto argumente.

II.10. Në datën 01.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1819/8, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1124/1 prot., datë 31.08.2023, me objekt: “*Dërgohet dokumentacioni i kërkuar në seancën dëgjimore datë 29.08.2023, lidhur me ankimin e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK nr.969 prot., datë 27.07.2023, me nr. ankimi elektronik A/2023/3307*”, ardhur me postë elektronike në KPP, bashkëngjitur shkresa me nr. 1124 prot., datë 31.08.2023, me objekt: “*Sqarime rreth seancës dëgjimore datë 29.08.2023, lidhur me ankimin e OE “Medfau” SHPK nr.969 prot., datë 27.07.2023, për procedurën e objekt Lot 1 “Blerje Kite Reagent*”, shkresa nr. 1782 prot., datë 30.12.2022 me objekt: “*Studimi i tregut për kite reagent*” dhe kopje e dokumenteve të tenderit “Blerje kite dhe reagentë për nevoja spitalore” me nr.ref- 36940-07-22-2022, datë 25.07.2022. I njëjti informacion, ardhur

me rrugë postare, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1819/9 prot., datë 04.09.2023, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës dhe CD.

II.11.Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Medfau” SHPK se: “Nuk plotesohet Kriteri 1.c - Nuk eshte paraqitur Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 si ne forme ashtu edhe ne permbajtje. Qendrim i mbajtur edhe nga KPP me Vendimin nr.183 dt.09.03.2023”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2/1, c “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është parashikuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
--------------	------------

<i>Emri i operatorit ekonomik:</i> <i>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)</i>	-----
<i>Numri NIPT/et:</i>	----- ---
<i>Adresa postare:</i> <i>Qyteti / qyteti; Kodi postar</i>	----- -----
<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	----- -----
<i>E-mail:</i>	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

- *Informacione për nënkontraktorin*

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- *Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>
<i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i>
<i>etj.</i>
<i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*

a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*

b) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*

b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*

a) *çmimet ;*

b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*

c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*

d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrot, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejjshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo []
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do	Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

<p><i>ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i></p>	
<p>Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Medfau” SHPK ka dorëzuar në SPE shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”.

III.1.3. Në ankesën e paraqitur, ankimuesi pretendon, se: “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, është dorëzuar nga operatori ekonomik, duke iu përmbajtur modelit të paraqitur në DST. Bashkëngjitur draft modeli në DST dhe formulari i dorëzuar në APP”.

III.1.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. *Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e*

prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

- c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;
- e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.
- ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriteve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.
- g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkëljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në pikat 1 dhe 2, të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.7. Në nenin 92, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.9. Në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ *Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

III.1.10. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.11. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.12. Në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik” pika “c” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione: [...]

c) miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik;”

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Agjencia e Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 10, datë 05.10.2022, “Për Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime” për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, në pikën 3 të tij, përcaktohet se: “ 3. Në çdo set të DST për mallra, punë, shërbime ndryshohet “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve, për këtë lloj procedure”.

III.1.14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e Autoriteti Kontraktor më datë 03.05.2023. Nga verifikimi i

dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumenteve standarde për procedurën e prokurimit Procedurë e Hapur, sipas vendimit nr. 10, datë 05.10.2022, me ndryshimet përkatëse konkretisht dhe të shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij.

III.1.15. Në përmbushje të kriterit të parashikuar në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2/1.c Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST-së, operatori ekonomik “Medfau” SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, nga verifikimi i të cilit konstatohen mospërputhje në formë, por edhe në përmbajtje me ndryshimet e bëra nga ana e Agjencisë Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022, të “Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit”. Konkretisht rezulton, se në pjesën 1: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik, është hequr informacioni që kërkohet nga autoriteti kontraktor në pikën “B”, “Deklaratë”, “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)”. Pra mungon pjesa e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
<ul style="list-style-type: none"> Informacione për nënkontraktorin 			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar
<ul style="list-style-type: none"> Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik 			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Operatori ekonomik ankimues, në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe me përmbajtjen e DST të miratuara nga APP sipas kompetencave që i njeh ligji (konkretisht nenin 23 pika “c” e LPP-së), ka hequr pjesën “B” “Deklaratë” “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)” të Formularit, duke ndërhyrë në përmbajtjen e shtojcës 8, pjesë e dokumentave standarde të tenderit. Kjo parregullsi konstatohet edhe në dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, bashkëngjitur ankesës së tij, ku rezulton, se formulari përmbledhes i vetëdeklarimit të plotësuar nga ankimuesi, nuk përmban pjesën B “Deklaratë” “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)”, pra kjo pjese me gjithë të dhënat që përmban, është hequr.

Gjithashtu, tek Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pika 8 duhet të ishte “*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi*”, dhe B Deklarata Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, pika 2 duhet të ishte:

“Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe/ose e saktë në çdo aspekt”;

Pika 5 a) dhe b) duhet të ishin:

“Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Risia e ndryshimit në këtë shtojcë lidhet me faktin, se nëse operatorët ekonomikë nuk bëjnë deklarime të sakta dhe/ose të plota në çdo aspekt, ata rrezikojnë që të skualifikohen ose përjashtohen jo vetëm nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, por edhe më gjerë nga fitimi i kontratave publike, nocion ky që përfshin të gjitha procedurat e prokurimit publik por edhe procedurat e koncesioneve, lejeve minerare, dhe ankandeve. Gjithashtu, ligjvënësi në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ndër të tjera ka përcaktuar, se *Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm*. Pra nga sa më sipër konstatohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi mund të përdorin një formular vetëdeklarimi të përdorur në një procedurë tjetër ose paralele prokurimi, me kusht që informacioni në përmbajtje duhet të vazhdojë të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Formulari i vetëdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, ndaj për faj të vetë operatorit ekonomik nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht pikës 2.1.c. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e

tenderit dhe në zbatim të LPP, çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Medfau” SHPK nuk ka ofertuar sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon, se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Medfau” SHPK duhet të kishte plotësuar shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi

Në rast se operatori ekonomik ofertues në këtë procedurë prokurimi do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti*

kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Medfau” SHPK nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “ Medfau” SHPK se: *“Nga kërkesat për pajisjet në përdorim, nuk plotësohet pika c “autorizimi i prodhuesit” - Eshtë ofruar pajisja Koagulometer CA 600 e prodhuesit Siemens, ndërsa Autorizimi i Prodhuesit është për pajisjen Koagulometer CA 560”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, për pajisjet në përdorim pranë SRMF, është parashikuar që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

a. Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve përfshirë aksesoret e tij të cilët OE do t'i instaloje duke bashkelidhur materialin përshkrues:

b. Lloji i pajisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plotë të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi

Shënim. Apartura dhe aksesoret të jenë sipas specifikimeve teknike të DS. Gjithashtu të ofrohet një sistem back up i aparaturës shoqëruar me listën e aksesoreve të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, të reagenteve dhe afatit të levrimit të pasqyruara në DS.

c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor i Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e pajisjeve të kërkuara në funksion të përdorimit të testeve nga AK sipas specifikimeve teknike të DT . (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar).

d. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. (pajisjeve) Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT . (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar).[...] .”

III.2.2. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për pajisjen koagulometër, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

“1- Dokumenti i titulluar “Autorizim i tenderit”, datë 12.06.2023, të lëshuar nga prodhuesi Siemens, Healthineers për shoqërinë “Medfau” SHPK, ku citohet se: “[...] autorizojmë “Medfau” SHPK për të paraqitur një ofertë qëllimi i së cilës është të sigurojë pajisje laboratorike (Advia Centaur XPT, Advia 560 Dimensionimi EXL 200, Koagulometri CA 560, Statusi Clinitec, Analizator i Gazit të Gjaktit dhe grup materialesh harxhuese dhe reagentësh në përdorim me këto pajisje sic kërkohet në këtë prokurim) të shpërndara nga ne në Spitalin Rajonal Memorial Fier.”

2. Deklaratë për pajisjet në përdorim, të shoqërisë “Medfau” SHPK, ku deklarohet lloji i pajisjes “Analizator Koagolimi” Modeli: CA 600, Viti i prodhimit 2021-2023, Kompania Prodhuese: Siemens Healthcare-Sysmex.

3. Katalog i Aparatit Modeli CA 600

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

III.2.5. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 5 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPPsë, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion*

apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Medfau” SHPK ka paraqitur në ofertën e tij dokumentin autorizim prodhuesi, konkretisht, referuar këtij dokumenti lëshuar nga prodhuesi “Siemens” në të cilin citohet: “[...]“*autorizojmë “Medfau” SHPK për të paraqitur një ofertë qëllimi i së cilës është të sigurojë pajisje laboratorike ([...] Koagolometri CA 560, dhe grup materialesh harxhuese dhe reagentësh në përdorim me këto pajisje siç kërkohet në këtë prokurim) të shpërndara nga ne në Spitalin Rajonal Memorial Fier.*” [...]”. Ndërkohë që Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka deklaruar, se për procedurën e prokurimit objekt – ankimimi, do të ofrojë llojin i pajisjes “Analizator Koagolimi” Modeli: CA 600, Kompania Prodhuese: Siemens Healthcare-Systeme, deklaratë të cilën e ka shoqëruar edhe me katalogun përkatës ku evidentohet modeli i aparatit CA 600. Në këtë rast rezulton, se modeli i ofruar sipas autorizimit të prodhuesit nuk është i njëjtë me modelin e deklaruar nga ofertuesi ankimues.

Synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga distributori zyrtar i autorizuar për mallrat objekt-prokurimi është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra objekt-prokurimi, pra autorizimi nga prodhuesi është një dokument nëpërmjet të cilit autoriteti kontraktor sigurohet që

subjekti/shoqëria që lëshon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që t'a furnizojë me produktet e tij duke siguruar garancinë e mallit, gjë e cila nuk garantohet me modelin e ofruar. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Medfau" ShPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Medfau" SHPK se: "Nuk permbushen specifikimet teknike të kerkuara për pajisjet në përdorim si vijon:

3.1. Pajisja Analizator Imunologjik: Modeli Advia Centaur XPT e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk ploteson specifikimet: (i) Si pajisje primare, nuk ploteson "Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin CMLA" - ofruar me metodologjinë e kemiluminishences kimike; (ii) Si pajisje back-up, nuk ploteson "Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA".

3.2. Pajisja Analizator Hematologjik: Modeli Advia 560 e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk ploteson specifikimin "Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl" – pajisja e ofruar ka vëllim maksimal të mostres 110 µl.

3.3. Pajisja Analizator për Gazet në Gjak: Modeli Rapid Poit 500, nuk ploteson specifikimin "Mostra e përdorur: 2-3 pika gjak i plote ose plasme".

3.4. Pajisja Analizator Koagulimi, është ofruar modeli CA 600 por nuk ka autorizim prodhuesi për këtë model por për modelin CA 560. Sidoqoftë, edhe modeli CA 600 i ofruar, nuk ploteson specifikimet e kërkuara, konkretisht: (i) "Aparati back up gjysëmatomik" – ofruar të dy aparatet automatik; (ii) "Metodologjia: Sistemi i detektimit I bazuar në viskozitet" – ofruar Photo-optical, continuous, sequential (Clotting/4, chromogenic, * and immunologic*); (iii) "Kapaciteti rreth 100 mostra" – max i ofruar nga pajisja është 60; (iv) "Te ofroje mundësinë e analizimit prioritar të mostrave STAT" – ofron vetëm 1 (STAT 1 priority position); (v) "Te jete i paisur me të pakten 4 kohëmatës të inkuorporuar në aparat me alarm zanor" – nuk e ofron.

3.5. Pajisja Analizator Biokimik: Modeli Dimension EXL 200, e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, si pajisje primare nuk ploteson specifikimin "Kapaciteti jo më pak se 800 teste/ore".

3.6. Pajisja Analizator Urine: Model i ofruar Clinitec Status, nuk ploteson specifikimin "Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore", para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik "Medfau" SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", në të cilin parashikohet se "1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre", Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e

ndërmarrja kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

III.3.1. Në specifikimet teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për pajisjet në përdorim, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

❖ **Specifikimet për pajisjet në përdorim**

• **Analizator Imunologjik**

Te ofrohet ne perdorim aparat per realizimin e analizave imunologjike me karakteristikat si me poshte:

- *Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin CMIA*
- *Kapaciteti minimal rreth 90 teste/ore*
- *Tipi i mostres se analizuar: serum, plasme, gjak i plote, urine*
- *Hollimi automatik i mostres*
- *Te jete e pajisur me sistem ftohje te integruar per te mundesuar stabilitetin e reagenteve ne aparat.*
- *Te ofroje mundesine e detektimit te koagolave apo flluskave te krijuara ne moster*
- *Operatori ekonomik te ofroje mundesine e nje aparati back up me karakteristikat si me poshte vijon:*
- *Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA.*
- *Rezultati te perftohet minimalisht ne 20 min dhe maksimalisht ne 120 minuta (ne varesi te parametrave te testuar).*
- *Analizim i njekohshem i parametrave te ndryshem.*
- *Monitori, tastiera dhe printeri te integruar ne aparat.*
- *Identifikimi i mostrave: nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.*
- *Te kete kapacitet maksimal jo me te vogel se 10 teste.*

- *Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.*

• **Analizator Hematologjik**

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje automatike të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- *Rezultate per 26 parametra te raportueshme duke përfshirë P-LCC, P-LCR*
- *Te perdore teknikat:Floë Citometri (laser me 3 kende) per numerimin dhe diferencimin e ËBC, metoden e impedancës elektrike për numërimin e RBC dhe trombociteve*
- *Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl*
- *Kapaciteti maksimal jo me pak se 60 mostra/orë*
- *Te kete kapacitet te ruajtjes jo me pak se 40000 rezultate (me grafiket perkates)*
- *Te mundesje matjen e hemoglobines perms metodes se kolorimetrise (reagent pa cyanide).*
- *Identifikimi i mostrave te realizohet nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem*
- *Printer per printimin e pergjigjeve te analizave*

- Operatori Ekonomik merr përsipër të kontribuojë në lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar.

- **Analizator për Gazet në Gjak**

Te ofrohet në përdorim aparat portabel I bazuar në përdorimin e katrrixheve për të analizuar gazet në gjak, elektrolitet, markerat kardiake, faktorët e koagulimit.

Karakteristikat e Aparatit:

-Rezultati i analizës të përftohet në intervalin kohor minimal jo më shumë se 2 min dhe maksimal jo më shumë se 20 min (në varesi të testit të realizuar).

-Mostra e përdorur: 2-3 pika gjak në plote ose plasmë

-Te përdoret metodën e matjes direkte elektrokimike.

- **Analizator Elektrolitik**

Te ofrohet në përdorim aparat plotësisht automatik për matjen e elektroliteve në 95 µl mostër përkatësisht:

-Gjak komplet, serum, plasëm të mund të testohen elektrolitet: Na⁺, K⁺, Cl⁻, Ca²⁺, Li⁺,

-Bikarbonat dializat të mund të testohen elektrolitet (Na⁺, K⁺, Cl⁻, Ca²⁺),

-Urinë e holluar të mund të testohen elektrolitet (Na⁺, K⁺, Cl⁻)

-Kohezgjatja e analizës jo më shumë se 1 minutë.

-Kapaciteti testues jo më pak se 45 mostra/ore

-Metodologjia e matjes: elektrode kapilare për matjen e Natriumit dhe elektrode membranore e lengshme për matjen e elektroliteve të tjera (K⁺, Cl⁻, Ca²⁺, Li⁺),

- Operatori Ekonomik merr përsipër të kontribuojë në lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar

- **Analizator Koagulimi**

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje (kryesore dhe back-up) të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Aparati kryesor plotësisht i automatizuar:

-Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar në viskozitet.

-Kapaciteti rreth 100 mostra.

-Te ofroje mundësinë e analizimit prioritar të mostrave STAT.

-Te realizojë hollimin automatik të mostrave

-Paisja duhet të realizojë back up automatik.

-Paisja duhet të identifikojë mostrat positive.

Aparati back up gjysëm-automatik:

-Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar në viskozitet

-Te jetë i paisur me të paktën 4 kohëmatës të inkuorporuar në aparat me alarm zanor.

-Operatori Ekonomik merr përsipër të kontribuojë në lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar

-Operatori Ekonomik duhet të ofrojë së bashku me aparaturën dhe materialet e konsumit të domosdoshme për 12 muaj për funksionimin e paisjes

- **Paisje Biokimike**

Te ofrohen ne perdorim 2 aparate biokimike plotesisht te automatizuar qe nga procesi i kalibrimit, kontrollit dhe testimi me karakteristikat e meposhtme:

Aparati Kryesor:

-Metodologjia: Integrim i 3 parimeve matese: Fotometri Turbidimetri, Potenciometri

-Kapaciteti jo me pak se 800 teste/ ore

-Tipologjia e mostres se perdorur: serum, plasmë, urine, CSF dhe gjak komplet

-Aparati duhet te realizoje hollim automatik te mostrave

-Identifikimi I mostrave duhet te realizohet nepermjet lexuesit automatik te barkodeve

-Te jete e pajisur me sistem ftohje te integruar per te mundesuar stabilitetin e reagenteve ne aparat.

Aparati back up:

-Metodologjia: Integrim i 4 parimeve matese: Fotometri absorbance, Turbidimetri, Polarimetri fluoreshente, Potenciometri (jon selective)

-Kapaciteti rreth 400 teste/ ore

-Tipologjia e mostres se perdorur: serum, plasmë, urine, CSF, hemolizat dhe gjak komplet (HbA1c)

-Aparati duhet te realizoje hollim automatik te mostrave

-Identifikimi I mostrave duhet te realizohet nepermjet lexuesit automatik te barkodeve

-Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.

-Të punojnë me ngarkesë të vazhdueshme

-Operatori ekonomik duhet te ofroje aparatin per distilimin e ujit nese nevojitet per zbatimin e protokollit te testeve biokimike si edhe materialeve te konsumit per kete aparat.

- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

-Operatori Ekonomik duhet të ofrojë së bashku me aparaturën dhe materialet e konsumit të domosdoshme për 12 muaj për funksionimin e paisjes.

- **Analizator Urine**

Te ofrohet ne perdorim aparat gjysmeautomatik per analizimin e stripeve te urines me karakteristikat e meposhtme:

-Metodologjia: Fotometri reflektance.

-Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore

-Te kete kapacitet te ruajtjes deri ne 1000 rezultate te mostrave dhe jo me shume se 300 rezultate te kontrolleve

-Printeri: Termal printer

-Parametrat e analizuar: pesha specifike, pH, leukocitet, nitrite, proteina, glukoza, ketonet, urobilinogen, bilirubine, eitrocite, hemoglobine, ngjyra.

-Te ofrohet mundesia e kalibrimit te testeve.

*-Identifikimi i mostrave: manualisht ose nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.
-Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuoje ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.*

Operatori Ekonomik merr përsipër te ofroje kitet per kalibrimin, kontrollin dhe materialet e nevojshme te konsumit qe jane te domosdoshme per ecurine normale te punes se paisjeve te lartpermendura.

Operatori Ekonomik merr përsipër te ofroje ne perdorim paisjet ndihmese per mbarevajtjen optimale te procesit te punes si me poshte vijon:

- **Centrifuge (2 cope)**

Te jepen ne perdorim 2 centrifuga per tubat e gjakut dhe urines me karakteristikat si me poshte:

Centrifuge me rotor te lire dhe kapacitet 30- 40x13mm per tubat e gjakut dhe centrifuge me rotor te fiksuar dhe kapacitet 20x15ml per tubat e urines.

- **Mikroskop (1 cope)**

Te jepet ne perdorim 1 mikroskop per ekzaminimin e gjakut dhe urines:

Mikroskop binokular me BE2 plan achromat.

Ndricimi: LED

Zmadhimi maksimal: 100x

- **Paisjet ndihmese si me poshte vijon:**

Perzieres per tubat e gjakut (1 cope)

Homogjenizues tubash (1 cope)

Barcode Printer dhe materialet e konsumit përkatëse (1 cope)

Pipeta (4 cope)

✓ *Koha e dorezimit, instalimit dhe vendosjes ne pune te aparateve do te jete 7 dite nga momenti I lidhjes se kontrates.*

III.3.3. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor, KPP për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerësoi të kryhet seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor.

III.3.4. Në datën 29.08.2023, ora 112.00, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore, ku prezent ishin përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore, e cila u regjistrua me audio, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor deklaroi, se në hartimin e specifikimeve teknike, referuar nenit 36 të LPP-së, është bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, por pa specifikuar se në cilin standard janë mbështetur. Me

qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, KPP i kërkoi informacion dhe dokumentacion autoritetit kontraktor, se në cilat standarde kombëtare apo ndërkombëtare është bazuar në hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve në përdorim. Gjithashtu, iu kërkua autoritetit kontraktor informacion mbi kryerjen e studimit të tregut lidhur me këto pajisje, ku të vërtetohet se ka më shumë se një prodhues të këtyre teknologjive të kërkuara dhe cili është roli i specifikimeve teknike në funksionalitetin e pajisjeve dhe a janë kërkuar standarde ekivalente. Komisioni i Prokurimit Publik i la afat autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimes, për dorëzimin e argumenteve dhe informacionit në KPP brenda dy ditëve nga mbajtja e kësaj seance.

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.6. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.7. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, pika 1, paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e

tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”* Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njëherë nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e

prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Konkretisht, KPP gjykon, se edhe në përputhje me nenin 134 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se *“Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet”*. Kështu,

në nenin 78, pika 1, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë, nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incumbit actor* (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, referuar nenit 27, pika 1 të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (si akt në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit), specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kështu, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, nuk mund të nisat vetëm nga procedura analoge të zhvilluara më parë nga po i njëjti autoritet kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore homologe, ose eprore, por në përputhje me parashikimet e ligjit.

Komisioni gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.3.7. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të

përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe **parimin e kontradiktoritetit**. Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me specifikimet teknike. Gjatë seancës në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykojti të nevojshëm sqarimin si mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin të paisjeve të secilit prej specifikimeve teknike të tyre.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Komisionin e Prokurimit Publik, argumenteve të dhëna në seancën dëgjimore nga të dyja palët, si dhe nga shqyrtimi i specifikimeve teknike për pajisjet në përdorim, Komisioni konstaton, se për pajisjen Analizator Imunologjik autoriteti kontraktor ka përcaktuar, se Sistemi imuno-analizues i automatizuar bazohet në parimin CMIA/ELFA, pa lejuar alternativa të tjera të cilat realizojnë të njëjtin funksionalitet.

Gjithashtu, konstatohet, se në specifikimet teknike të pajisjes Analizator për gazet në gjak është kërkuar treguesi teknik “mostra e përdorur 2-3 pika gjak i plotë ose plazme”.

Përcaktimi 2-3 pika gjak, është një përcaktim i përgjithshëm dhe nuk përshkruan qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar kërkesave funksionale ose të performancës, pasi nuk përcaktohet njësia matëse e pikës së gjakut, e cila varet nga droperi i pipetës nga ku merret mostra.

Konstatohet, se për pajisjen Analizator koagulimi përveç specifikimeve të tjera, është kërkuar treguesi : “Kapaciteti rreth 100 mostra” dhe për pajisjen “Analizator urine” është parashikuar treguesi teknik: “Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore”.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht, se si ndikojnë këto specifikime teknike në funksionalitetin e pajisjeve. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar, se në cilat standarde është mbështetur në hartimin e specifikimeve teknike për këto pajisje.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh, me qëllim përfitimin e një produkti me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, si në rastin konkret ku është shprehur “rreth 100 mostra”, “rreth 600 stripe urine/ore” apo “2-3 pika gjak”, por duhet të përcaktojë parametra minimalë dhe me diapazon të gjerë, duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave, në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në dokumentacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar, se në cilat standarde kombëtare apo ndërkombëtare është bazuar në hartimin e këtyre specifikimeve teknike, referuar nenit 36 të LPP-së.

KPP thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale, por nuk mund të kufizojë konkurrencën, duke vendosur specifikime teknike të cilat nuk arrin t'i justifikojë me argumenta konkrete dhe shkencore. Specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.3.9. Sa më sipër cituar, bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se specifikimet teknike të sipërcituara, nuk janë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe për sa kohë që shkakton pasaktësi, si te operatorët ekonomikë ofertues ashtu edhe të Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, kjo përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi specifikime që nuk janë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi, duke hartuar specifikime të sakta dhe të qarta, në përputhje me parashikimet ligjore.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufurin e lartë monetar”, me Nr.REF-67972-05-02-2023, me objekt: “Loti 1, ‘Blerje kite dhe reagentë’” me fond limit 67.301.415,2 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

